

II. Vërejtje për shfrytëzuesit

1. Përbërja

Përmbledhja e V-të e Ligjeve të aplikueshme mbi taxat në Kosovë, përfshin Rregulloret dhe Urdhëresat Administrative e UNMIKUT të cilat themelojnë dhe rregullojnë taxat në Kosovë

2. Aplikueshmëria

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje në Kosovë, përcaktojnë ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, ligje të aplikueshëm janë "*ligjet në fuqi më 22 mars 1989*" (neni 1.1 (b), dhe Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet tjera plotësuese të shpallura më pastaj.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 thekson se "Kuvendi ka këto përgjegjësi: (a) miratimin e ligjeve dhe rezolutave që hyjnë në përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, sikundër është cekur në kapitullin 5" (shih nenin 9.1.26 dhe kapitullin 5).

Shfrytëzuesit e kësaj përmbledhje këshillohen që ti qasen veç e veç çdo pjese të tekstit të këtyre rregulloreve (që gjenden në përmbledhjen V) në mënyrë që të përcaktojnë aplikueshmërinë e çfardo ligji apo dispozite ligjore.

3. Autenticiteti

Ju lutemi veni re, nëse paraqitet çfardo mospërputhje në interpretimin e përmbajtjes së teksteve, mbështetuni në versionin e gjuhës Angleze.

4. E Drejta e Autorit

Asnjë pjesë e kësaj përmbledhje nuk mund të shumëzoht ose të përcillet në ndonjë formë apo mënyrë tjetër pa autorizimin paraprak nga QJK-ës.